



**Informatë për shtyp - 314/04/2020**

24.04.2020  
faqe 1 nga 3

## **Qeveria e Landit vendos përdorimin e detyruar të maskave**

Zyra e Shtypit të Kancelarisë  
Shtetërore  
40213 Düsseldorf  
Telefon 0211 837-1134  
0211 837-1405  
oder 0211 837-1151

**Rregullimi e mbulimit të detyruar të gojës dhe hundës vlen që nga 27 prilli 2020 në trafikun publik, në dyqane dhe tek qendrat mjekësore**

[presse@stk.nrw.de](mailto:presse@stk.nrw.de)  
[www.land.nrw](http://www.land.nrw)

### **Qeveria e Landit informon:**

Që nga e hëna, 27 prill 2020, në Nordrhein-Westfalen vlen detyrimi i qytetarëve që të mbulojnë gojën dhe hundën tek udhëtimet në trafikun publik tek blerjet në dyqane dhe tek vizitat e tyre në qendrat mjekësore. Qëllimi është, që rreziku i përhapjes së virusit të reduktohet në fushat e rëndësishme të jetës publike, ku është e vështirë ose e pamundur të mbahet distanca prej 1,5 metrash.

Rregullorja administrative e mbrojtjes nga korona është aktualizuar në mënyrë përkatëse dhe ka zëvendësuar rekomandimin e deritashëm dhe paraqet në një pragraf të veçantë detyrimin përkatës juridik në fushën e trafikut publik, në dyqane dhe tek qendrat mjekësore. Në këto fusha është i detyrueshëm bartja e një mbuluese nga tekstili për të mbuluar gojën dhe hundën, si të ashtuquajturat „maska të përditshme“, poashtu „maskat e komunitetit“ ose me një shall ose pjesë tjetër mbuluese.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann „Me rregulloren administrative të sotme rregullojmë çështjet e hapura të detyrimit për mbrojtjen e gojës. Më e rëndësishmja mbetet: Mbajtja e distancës dhe përmbajtja konsekuente e rregullave të higjenës. Edhe bartja e maskave të përditshme mund të kontribuojë në situata të caktuara që të reduktohet rreziku i infektimit. Unë apeloj tek të gjithë qytetarët: Ju lutem pëmbajuni këtyre rregullave! Rregulloret tona të deritashme po i tregojnë rezultatet. Sistemi jonë i shëndetësisë është treguar i mirë dhe nuk ka hasur deri më tani në kufijtë e tij. Çdo njëri prej nesh duhet të kontribuoj në këtë.“

**Përgjithësisht vlen:** Në hapësirën publike duhet të mbahet distanca minimale tek të gjithë personat tjerë prej 1,5 metrash. Këtu vlejnë edhe

më tutje përjashtimet për shembull për të afërmit e linjës së parë, vëllezër dhe motra ose për personat që jetojnë në një bashkësi familjare. Po që se nuk është e mundur të mbahet kjo distancë, atëherë rekomandohet bartja e një mbulese për gojë dhe hundë.

Për të punësuarit dhe konsumatorët është i obligueshëm mbulimi i gojës dhe hundës në disa fusha. Kjo vlen

- në vendet e lejuara për shitje dhe në dyqanet tregtare (p.sh. në dyqanet me gjëra ushqimore, barnatore, pompa të karburanteve, banka ose posta), në tregjet e ndryshme gjatë javës, tek marrja e ushqimeve dhe pijeve në gastronomi si dhe hapësirat tjera të qendrave tregtare, „Shopping Malls“ oder „Factory Outlets“,
- në hapësirat tjera të shitjes dhe paraqitjes së produkteve dhe shërbimeve si dhe tek ofrimi ose pranimi i shërbimeve ose zejeve të ndryshme, tek të cilat nuk mund të përmbahet distanca e sigurisë prej 1,5 metrash tek konsumatorët. Nga kjo rregullore janë të përjashtuar personat, që në punën e tyre duhet të drejtojnë makina.
- në qendrat mjekësore dhe objektet e ngjashme në shëndetësi.
- tek shfytëzimi i trafikut publik si dhe objektet tjera. Këtu përfshihen autobusët e shkollave, stacionet dhe stacionet e trenit.

Detyrimi për mbulimin e gojës dhe hundës vlen për të gjithë qytetarët në Nordrhein-Westfalen. Përjashtimet vlejnë për fëmijë parashkollor dhe personat, që për arsye mjekësore nuk mund të bartin mbulesën e gojës dhe hundës. Për punonjësit mund të zëvendësohet ky detyrim përmes një mase mbrojtëse si ndarja përmes një xhami, pleksixhami ose diçka të ngjashme.

Përmbajtja e rregullave duhet të sigurohet nga pronarët e bizneseve brenda hapësirës së biznesit si dhe duhet të përmbahen kushtet e deritashme për distancën minimale, kufizimin e personave etj.

Ndryshimi i rregullores administrative për mbrojtje nga korona vlen për hapësirën kohore prej 27.04. prillit deri së paku më 3 maj 2020. Kjo rregullore mund të gjindet këtu:

[https://www.land.nrw/sites/default/files/asset/document/stk\\_verordnung\\_24.04.2020.pdf](https://www.land.nrw/sites/default/files/asset/document/stk_verordnung_24.04.2020.pdf)

**Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit**  
**[www.land.nrw](http://www.land.nrw)**

Seite 3 von 3

**[Udhëzime të përgjithshme për mbrojtjen e datave](#)**